



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 207

31 dhjetor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 1068, datë 14.12.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 719, datë 20.10.2011 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, Sarandë”..... 9183
Vendim i KM nr. 1072, datë 14.12.2013	Për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me një përfaqësues të Policisë së Shtetit, në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)..... 9183
Vendim i KM nr. 1081, datë 18.12.2013	Për krijimin e Komisionit Ndërinstitucional për bashkërendimin e punës në zbatimin e projektit të gazsjellësit Trans Adriatik Pipeline (TAP)..... 9185
Vendim i KM nr. 1082, datë 18.12.2013	Për ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 110 kv Kukës (Shqipëri) - Prizren (Kosovë)..... 9186
Vendim i KM nr. 1085, datë 18.12.2013	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Financave te Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, të pronës së paluajtshme shtetërore me numër pasurie 7/124, në zonën kadastrale 8270, me vendndodhje në rrugën “Dora d’Istria”, Tiranë, për t’u përdorur nga ALUIZNI 9187
Vendim i KM nr. 1086, datë 14.12.2013	Për krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike 9191
Urdhër i MF nr. 86, datë 18.12.2013	Për shpalljen e ndryshimeve në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe..... 9192

VENDIM
Nr. 1068, datë 14.12.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 719, DATË 20.10.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE TË MIDHJES DHE PESHKIMIT, SARANDË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 66 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të nenit 6 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9000 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 719, datë 20.10.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në të gjithë vendimin, emërtimi “Drejtoria e Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit” zëvendësohet me “Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës”.

b) Në pikën 2, fjalët “... si institucion publik me qendër në Sarandë, në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave...” zëvendësohen me “... si institucion publik me seli në Tiranë, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave...”.

c) Në pikat 3 dhe 6, emërtimi “Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me “Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”.

ç) Në pikën 7, fjalët “... financohet nga buxheti i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave...” zëvendësohen me “... financohet nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave...”.

d) Në pikën 8, fjalët “... me propozimin e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave...” zëvendësohen me “... me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave...”.

dh) Në pikën 10, emërtimi “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me “Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”.

2. Efektet financiare për vitin 2013 përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mjedisit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1072, datë 14.12.2013

PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME NJË PËRFAQËSUES TË POLICISË SË SHETËTIT, NË MISIIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË SUDANIN E JUGUT (UNMISS)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 10 438, datë 28.6.2011 “Për pjesëmarrjen e Policisë së Shtetit në misione policore, paqeruajtëse dhe humanitare jashtë vendit”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në



Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me një përfaqësues nga Policia e Shtetit, në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS), Departamenti i Misioneve Paqeruajtëse të OKB-së, Divizioni i Policisë, në kuadër të kontributit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Misioni dhe detyrat e punonjësit të Policisë së Shtetit janë:

- këshillimi;
- rekrutimi;
- trajnimi i punonjësve të Policisë Kombëtare në Sudanin e Jugut (pra, përfitues i kontributit të Shqipërisë është OKB-ja në Misionin e Sudanit të Jugut - UNMISS), në mënyrë që të zhvillohet një forcë policore kombëtare e pavarur dhe profesionale në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare të OKB-së.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është për një periudhë fillestare 1 (një) vit, me mundësi zgjatjeje të këtij afati.

4. Policia e Shtetit merr përsipër:

a) shpenzimet për trajnimin paraprak njëjavor në Juba, Sudani i Jugut;

b) sigurimin e uniformës, pajisjeve dhe materialeve, sipas listës së rekomanduar nga OKB-ja.

5. Efektet financiare për periudhën njëvjeçare, gjatë kryerjes së shërbimit, përballohen nga OKB-ja, ku përfshihen shpenzimet e transportit vajtje-ardhje për në vendin e dislokimit, akomodimi, sigurimi shëndetësor dhe shpenzimet e jetës, referuar udhërrëfyesit të Kombeve të Bashkuara për oficerët e policisë, të emëruar në operacionet paqeruajtëse dhe në rregulloret e tjera përkatëse të Kombeve të Bashkuara.

6. Efektet financiare, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të përballohen nga Policia e Shtetit.

7. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

000/lekë

LLOGARITJA E SHPENZIMEVE PËR PERSONELIT E POLICISË ME MISION NË OKB (UNMISS), SUDANI I JUGUT-JUBA

Nr.	Zërat e shpenzimeve	Numri i forcave	UNMISS, Sudani i Jugut-Juba		
			Kostoja për një p/policie në ditë në 000/lekë	Kostoja për një p/policie për fazë në 000/lekë	Kostoja totale për të gjithë kontingjentin në 000/lekë
1	Shpenzime për trajnimin paraprak 1-javor (njëjavor)	1	10	70	70
2	Sigurimi i uniformës, pajisjeve dhe materiale shëndetësore, sipas kërkesave të OKB-së	1	295	295	295
	TOTALI I SHPENZIMEVE				365

VENDIM
Nr. 1081, datë 18.12.2013

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT NDËRINSTITUCIONAL PËR BASHKËRENDIMIN E
PUNËS NË ZBATIMIN E PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT
TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 116/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”, të ligjit nr. 104/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë, për projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP)”, dhe të nenit 4 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit Ndërinstitucional për bashkërendimin e punës në zbatimin e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik Pipeline (TAP), i emërtuar “Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP”.

2. Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP kryesohet nga ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- Zëvendësministrin e Energjisë dhe Industrisë;
- Zëvendësministrin e Punëve të Brendshme;
- Zëvendësministrin e Financave;
- Zëvendësministrin e Drejtësisë;
- Zëvendësministrin e Mjedisit;
- Zëvendësministrin e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
- Zëvendësministrin e Transportit dhe Infrastrukturës;
- Zëvendësministrin e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- Zëvendësministrin e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
- Drejtorin e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë;

- Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Doganave;
- Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve;
- Zëvendëskryerregjistruesin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

3. Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP ka këto përgjegjësi dhe detyra:

a) Bashkërendimin e punës në zbatimin e detyrimeve kontraktore të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik, dhe marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë, për projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP), të ratifikuara nga Kuvendi.

b) Bashkërendimin ndërmjësor të punës për formulimin e qëndrimeve që do t'i paraqiten për trajtim dhe/ose vendimmarrje Këshillit të Ministrave dhe, sipas rastit, Kuvendit, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik



Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik, dhe marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë, për projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP), të ratifikuara nga Kuvendi.

c) Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me institucionet e pavarura dhe/ose entet rregullatore të Republikës së Shqipërisë, që kanë detyra ose janë përgjegjëse për zbatimin e detyrave në realizimin e projektit TAP, në kuadër të marrëveshjeve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi.

ç) Përcaktimin e detyrave për institucionet dhe subjektet e varësisë të ministrive dhe kontrollin e zbatimit të tyre.

4. Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP mbledhet çdo 3 (tre) muaj ose në çdo kohë, me kërkesë të kryetarit.

5. Në mbledhjet e Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore dhe të institucioneve të tjera të interesuara, kur çmohet se pjesëmarrja e tyre do të jetë e vlefshme për përmbushjen e misionit të bashkërendimit të punës në zbatimin e projektit TAP.

6. Kryetari i Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP i raporton Kryeministrit për ecurinë e realizimit të projektit TAP, problematikat e hasura, masat e ndërmarra dhe rezultatet konkrete të arritura, si dhe për çështje të veçanta.

7. Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP ndihmohet nga sekretariati teknik, i cili ka këto detyra kryesore:

- përgatitjen e takimeve të këtij Komisioni;
- raportimin periodik në mbledhjet e këtij Komisioni mbi realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme ose që janë në zbatim të marrëveshjeve, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi;
- bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për zbatimin e detyrave të këtij Komisioni, si dhe monitorimin e zbatimit të këtyre detyrave;
- bashkërendimin e punës me shoqërinë TAP AG për aspektet e ndryshme të plotësimit të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë, që lindin nga marrëveshjet e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi;
- mbështetjen e shoqërisë TAP AG në proceset dhe marrëdhëniet me institucionet që janë të përfaqësuara në këtë Komision;
- kryerjen e detyrave të tjera që përcaktohen nga kryetari i këtij Komisioni.

8. Përbërja, mënyra e funksionimit dhe detyrat e hollësishme të sekretariatit teknik përcaktohen me urdhër të ministrit të Energjisë dhe Industrisë.

9. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe institucionet e përfaqësuara në Komisionin Ndërinstitucional për Projektin TAP për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1082, datë 18.12.2013

PËR NDËRTIMIN E LINJËS SË INTERKONJEKSIONIT 110 KV
KUKËS (SHQIPËRI) - PRIZREN (KOSOVË)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të linjës së interkonjeksionit 110 kV Kukës (Shqipëri) - Prizren (Kosovë) nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a.

2. Kostot financiare të ndërtimit të linjës së interkonjeksionit 110 kV Kukës (Shqipëri) - Prizren (Kosovë), në territorin shqiptar, përballohen nga fondet e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a.

3. Autorizohet ministri i Energjisë dhe Industrisë për nënshkrimin e marrëveshjes përkatëse me ministrin përgjegjës për energjinë të Republikës së Kosovës.

4. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe shoqëria “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1085, datë 18.12.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E FINANCAVE TE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT, TË PRONËS SË PALUAJTSHME
SHTETËRORE ME NUMËR PASURIE 7/124, NË ZONËN KADASTRALE 8270, ME
VENDNDODHJE NË RRUGËN “DORA D’ISTRIA”, TIRANË, PËR T’U PËRDORUR NGA
ALUIZNI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Financave te Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, të pronës së paluajtshme shtetërore me numër pasurie 7/124, në zonën kadastrale 8270, me vendndodhje në rrugën “Dora d’Istria”, Tiranë, sipas planvendosjes dhe formularit që i bashkëlidhen këtij vendimi, për t’u përdorur për mjedise pune nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI).

2. Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama




HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUEJTSHME TIRANË REGJISTRUES Elona Bici <i>Vula/Firma</i>	A. IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE 8270 NR. I PASURISE: 7/124 VOL 58 FQ 175 INDEKSI I HARTES: TR-T-11 SHKALLA: 1:1000 ADRESA E PASURISE: Rrethi Tiranë Q/F Tiranë Rr/L: DORAD'ISTRIA P/G SH K Ap B. KUFIZIMET V. _____ L. _____ J. _____ P. _____ C. PRONARI SHITET D. Data: 09/12/2013 Ora: 10:22:13AM
--	---

X: 400948.18
Y: 4576479.779

X: 401140.003
Y: 4576485.654



X: 400948.18
Y: 4576336.904

X: 401140.003
Y: 4576336.904

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni / Pushteti Qendror : MZHUT											
Bashkia: Tirane											
Fusha e perdorimit te Prones : Administrative											
A				B			C				
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m ²)	Nga Sip. Totale Sa Ndertese (m ²)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdores Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1	8270 TR-T-11	7/124	Truall ndertese	Godina e ALLUZNIT-Rruga Dora D'Ishtia Tirane	2019	806	Administrative	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	ALLUZNI	Ne kete ndertese ka ushtruar aktivitetin me pare Drejtoria e Auditit dhe DPPP, ne Ministrine e Finances	



**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordan Misja, Tirane

TIRANË, me 9 / 12 / 2013
SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me originalin e ndodhur në zyrën tone
Në regjistrin Vol 55, Faqe 175, Zona Kadastrale 8270, Qyteti Tiranë

REGJISTRUESI
ELONA BICI

VENDIM
Nr. 1086, datë 14.12.2013

**PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË ARKËTIMEVE
DHE ULJEN E NIVELIT TË HUMBJEVE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

2. Kjo Task-Forcë drejtohet nga zëvendëskryeministri dhe ka në përbërje:

- | | |
|---|------------------|
| - Ministrin e Energjisë dhe Industrisë | zëvendëskryetar; |
| - Zëvendësministrin e Energjisë dhe Industrisë | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Punëve të Brendshme | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Drejtësisë | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Financave | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë | anëtar; |
| - Administratorin e "CEZ Shpërndarje" sh.a. | anëtar; |
| - Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit | anëtar; |
| - Drejtorin e Përgjithshëm të Ujësjellës-Kanalizimeve | anëtar. |

3. Task-Forca për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, ka këto funksione:

- Hartimin e një plani masash administrative dhe organizative për fuqizimin dhe rritjen e frytshmërisë së strukturave të "CEZ Shpërndarje" sh.a., për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve, evidentimin dhe ndërprerjen e lidhjeve e të ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarjes dhe në sistemin e matjes së energjisë elektrike.

- Bashkërendimin e punës me strukturat e "CEZ Shpërndarje" sh.a. dhe institucionet e tjera shtetërore për identifikimin dhe zbatimin e masave në funksion të përmirësimit të nivelit të arkëtimeve të detyrimeve të energjisë elektrike.

- Bashkërendimin e punës me strukturat e "CEZ Shpërndarje" sh.a., për përcaktimin e zonave të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për të cilat kërkohet ndërhyrje emergjente për zbatimin e masave teknike.

- Bashkërendimin e punës me strukturat e Policisë së Shtetit, sipas qarqeve, për mbështetjen e veprimeve në terren të punonjësve të "CEZ Shpërndarje" sh.a., gjatë ndërprerjeve të lidhjeve të paligjshme dhe ndërprerjeve për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve të energjisë elektrike.

- Bashkëpunimin me strukturat e Policisë së Shtetit për ndjekjen me përparësi të kallëzimeve penale të depozituara nga "CEZ Shpërndarje" sh.a.

- Kontrollin e zbatimit të detyrave të lëna për njësitë operative vendore dhe institucionet e tjera të ngarkuara në përputhje me këtë vendim.

- Bashkërendimin e punës me Entin Rregullator të Energjisë për një program të posaçëm që përgatitet nga "CEZ Shpërndarje" sh.a., ku parashikohet kryerja e investimeve emergjente në funksion të uljes së humbjeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në zonat më problematike.

- Evidentimin e nevojave emergjente për t'i paraprirë punës me ndryshimet e mundshme të kuadrit ligjor, nënligjor e rregullator, të cilat ndikojnë në përmirësimin e treguesve të nivelit të humbjeve e të nivelit të arkëtimeve të energjisë elektrike dhe përgatitjen e propozimeve përkatëse.



- Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me Entin Rregullator të Energjisë për masat e nevojshme rregullatore që duhet të merren për realizimin e funksioneve themelore të Task-Forcës.

4. Brenda datës 31 dhjetor 2013, nën drejtimin e prefektëve sipas qarqeve, të ngrihen njësitë operative vendore, të cilat i raportojnë 1 (një) herë në muaj kryetarit të Task-Forcës për masat e marra dhe rezultatet e arritura për ndjekjen e detyrave të parashikuara në këtë vendim.

5. Task-Forca për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike ndihmohet nga sekretariati teknik. Ngarkohet ministri i Energjisë dhe Industrisë për ngritjen e këtij sekretariati dhe për përcaktimin e përbërjes e të mënyrës së funksionimit të tij.

6. Periudha e veprimit të Task-Forcës të jetë deri më 31 dhjetor 2014.

7. Në mbledhjet e Task-Forcës, sipas problematikave që mund të konstatohen, ftohen të marrin pjesë ekspertë të fushës, përfaqësues të institucioneve të tjera të interesuara dhe të organeve të qeverisjes vendore, kur çmohet se pjesëmarrja e tyre do të jetë e vlefshme për përmbytjen e misionit të saj.

8. Ngarkohen zëvendëskryeministri, ministri i Energjisë dhe Industrisë, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Drejtësisë, ministri i Financave, ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe administratori i “CEZ Shpërndarje” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR

Nr. 86, datë 18.12.2013

PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE NË STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT DHE TË RAPORTIMIT FINANCIAR, TË PËRKTHYERA NË GJUHËN SHQIPE

Në mbështetje të nenit 4, pika 3 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar, të vendimit nr. 1, datë 4.12.2013 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit “Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve të ndodhura për SNRF-të gjatë vitit 2013”, të cilat hyjnë në zbatim nga 1 janari i vitit 2014,

URDHËROJ:

Shpalljen e ndryshimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), si më poshtë:

	Data efektive
1. Interpretimi 21 i KIRFN-së taksat	1 janar 2014
2. Ndryshime të SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27-Njësitë ekonomike investuese	1 janar 2014
3. Ndryshime në SNK 39 – Zëvendësimi i derivativëve dhe vazhdimi i kontabilitetit mbrojtës	1 janar 2014
4. Ndryshimet në SNK 36-Dhënia e informacioneve shpjeguese për shumën e rikuperueshme për aktivet jo-financiare.	1 janar 2014

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

INTERPRETIMI 21i KIRFN-së *Taksat*

Referencat

- SNK 1 *Paraqitja e pasqyrave financiare*
- SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*
- SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*
- SNK 20 *Kontabiliteti për grantet qeveritare dhe dhënia e informacioneve shpjeguese për ndihmën qeveritare*
- SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura*
- SNK 34 *Raportimi financiar i ndërmjetëm*
- SNK 37 *Provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara*
- KIRFN 6 *Detyrimet që rrjedhin nga pjesëmarrja në një treg specifik – Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike*

Konteksti

- 1 Një qeveri mund të vendosë një taksë mbi një njësi ekonomike. Komiteti i Interpretimeve i SNRF-ve ka pranuar kërkesat për udhëzim mbi kontabilitetin për taksat në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike që paguan taksën. Çështja është se kur do njihet një detyrim për të paguar një taksë që është kontabilizuar në përputhje me SNK 37 *Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara*.

Objekti

- 2 Ky Interpretim trajton kontabilitetin për një detyrim për të paguar një taksë në qoftë se detyrimi është brenda objektit të SNK 37. Ai gjithashtu trajton kontabilitetin për një detyrim për të paguar një taksë që ka shumë dhe afat të sigurtë.
- 3 Ky Interpretim nuk trajton kontabilitetin për kostot që lindin nga njohja e një detyrimi për të paguar një taksë. Njësitë ekonomike duhet të zbatojnë standardet e tjera për të vendosur nëse njohja e një detyrimi për të paguar një taksë shkakton një aktiv ose një shpenzim.
- 4 Për qëllime të këtij Interpretimi, një taksë është një dalje e burimeve, që përfshijnë përfitime ekonomike, e cila vendoset nga qeveritë mbi njësitë ekonomike në përputhje me legjislacionin (dmth ligjet dhe / ose rregulloret), përveç:
 - (a) atyre daljeve të burimeve që janë brenda objektit të Standardeve të tjera (të tilla si tatimet mbi të ardhurat që janë brenda objektit të SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*); dhe
 - (b) gjyba ose sanksione të tjera që vendosen për shkelje të legjislacionit.
 ‘Qeveri’ i referohet qeverisë, agjencive qeveritare dhe organeve të ngjashme qofshin lokale, kombëtare apo ndërkombëtare.
- 5 Një pagesë e bërë nga një njësi ekonomike për blerjen e një aktivi, ose për kryerjen e shërbimeve sipas një marrëveshjeje kontraktuale me një qeveri, nuk plotëson përkufizimin e një takse.
- 6 Një njësi ekonomike nuk i kërkohet të zbatojë këtë Interpretim për detyrimet që lindin nga skemat e tregimit të emetimeve.

Çështjet

- 7 Për të sqaruar kontabilitetin për një detyrim për të paguar një taksë, ky Interpretim trajton çështjet e mëposhtme:
 - (a) cila është ngjarja detyruese që çon në njohjen e një detyrimi për të paguar një taksë?
 - (b) a krijon detyrimi ekonomik për të vazhduar operimin për një periudhë të ardhshme, një detyrim konstruktiv për të paguar një taksë që do të shkaktohej nga veprimtaria në këtë periudhë të ardhshme?



- (c) a nënkupton supozimi i vijimësisë se njësi ekonomike ka një detyrim aktual për të paguar një taksë që do të shkaktohej nga veprimtaria në një periudhë të ardhshme?
- (d) a bëhet njohja e një detyrimi për të paguar një taksë në një moment kohor ose, në disa rrethana, bëhet në mënyrë progresive me kalimin e kohës?
- (e) cila është ngjarja detyruese që çon në njohjen e një detyrimi për të paguar një taksë që shkaktohet nëse është arritur një prag minimal?
- (f) a janë të njëjta parimet për njohjen e një detrimi për të paguar një taksë, në pasqyrat financiare vjetore dhe në raportin financiar të ndërmjetëm të?

Konsensusi

- 8 Ngjarja detyruese, që krijon një detyrim për të paguar një taksë, është veprimtaria që shkakton pagesën e taksës, siç është identifikuar nga legjislacioni. Për shembull, në qoftë se veprimtaria që shkakton pagesën e taksës është gjenerimi i të ardhurave në periudhën aktuale dhe llogaritja e kësaj takse bazohet në të ardhurat që janë gjeneruar në një periudhë të mëparshme, ngjarje detyruese për këtë taksë është gjenerimi i të ardhurave në periudhën aktuale. Gjenerimi i të ardhurave në periudhën e mëparshme është i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm, për të krijuar një detyrim aktual.
- 9 Një njësi ekonomike nuk ka një detyrim konstruktiv për të paguar një taksë që do të shkaktohej nga veprimtaria në një periudhë të ardhshme për faktin që njësi ekonomike do të ishte ekonomiksht e detyruar të vazhdonte të operonte në këtë periudhë të ardhshme.
- 10 Përgatitja e pasqyrave financiare sipas supozimit të vijimësisë nuk do të thotë se një njësi ekonomike ka një detyrim aktual për të paguar një taksë që do të shkaktohej nga veprimtaria në një periudhë të ardhshme.
- 11 Detyrimi për të paguar një taksë njihet në mënyrë progresive nëse ngjarja detyruese ndodh gjatë një periudhe kohore (p.sh. nëse aktiviteti që shkakton pagesën e taksës, siç është identifikuar nga legjislacioni, ndodh gjatë një periudhe kohore). Për shembull, në qoftë se ngjarja detyruese është gjenerimi i të ardhurave gjatë një periudhe kohore, detyrimi korrespondues njihet kur njësi ekonomike gjeneron këto të ardhura.
- 12 Në qoftë se një detyrim për të paguar një taksë shkaktohet kur arrihet një prag minimal, kontabiliteti për detyrimin që lind nga ky detyrim do të jetë në përputhje me parimet e përcaktuara në paragrafët 8-14 të këtij Interpretimi (në veçanti, paragrafët 8 dhe 11). Për shembull, në qoftë se ngjarje detyruese është arritja e një pragu minimal të aktivitetit (të tilla si një sasi minimale të të ardhurave apo shitjeve të gjeneruara apo rezultateve të arritura), detyrimi korrespondues njihet kur është arritur ky prag minimal i aktivitetit.
- 13 Një njësi ekonomike do të zbatojë në raportin financiar të ndërmjetëm të njëjtat parime të njohjes që zbaton edhe në pasqyrat financiare vjetore. Si rezultat, në raportin financiar të ndërmjetëm, një detyrim për të paguar një taksë.
 - (a) nuk do të njihet në qoftë se nuk ka asnjë detyrim aktual për të paguar taksë në fund të periudhës raportuese të ndërmjetme; dhe
 - (b) do të njihet në qoftë se ka një detyrim aktual për të paguar taksë në fund të periudhës raportuese të ndërmjetme;
- 14 Një njësi ekonomike do të njohë një aktiv, nëse ajo ka parapaguar një taksë, por ende nuk kanë një detyrim aktual për ta paguar këtë taksë.

Shtojca A

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Interpretimit dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të Interpretimit.

- A1 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Interpretim për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2014 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Interpretim për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2014, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- A2 Ndryshimet në politikat kontabël që rezultojnë nga zbatimi fillestar i këtij Interpretimi duhet të kontabilizohen në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat Kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*.

ZËVENDËSIMI I DERIVATIVËVE DHE VAZHDIMI I KONTABILITETIT MBROJTËS (NDRYSHIME NË SNK 39)

Ndryshimet në SNK 39 Instrumentet financiare: *Njohja dhe matja*

Paragrafët 91 dhe 101 janë ndryshuar. Teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është hequr viza mes përmes.

Mbrojtjet me vlerën e drejtë

- ...
- 91 Një njësi ekonomike do të ndërpresë në mënyrë prospektive kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafin 89 nëse:
- (a) instrumenti mbrojtës ka skaduar ose është shitur, nuk merren më përfitime ose është ushtruar. ~~Për këtë qëllim, zëvendësimi apo përtëritja e një instrumenti mbrojtës në një instrument tjetër nuk konsiderohet skadim apo ndërprerje e afatit nëse ky zëvendësim ose kjo përtëritje është pjesë e strategjisë mbrojtëse të dokumentuar e njësisë ekonomike~~. Përveç kësaj, për këtë qëllim nuk ka skadim apo ndërprerje të afatit të instrumentit mbrojtës, nëse:
 - (i) si pasojë e ligjeve apo rregulloreve apo futjes së ligjeve ose rregulloreve, palët e instrumentit mbrojtës janë dakord që një ose më shumë prej palëve të tjera të kleringut të zëvendësojnë palën tjetër fillestare të tyre për t'u bërë palë tjetër e re në secilën prej palëve. Për këtë qëllim, një palë tjetër kleringu është pala tjetër kryesore (e quajtur nganjëherë një "organizatë kleringu 'ose' agjenci kleringu') ose një njësi ekonomike apo disa njësi ekonomike, për shembull, një anëtar i një organizate kleringu ose një klient i një anëtarit kleringu të një organizate kleringu, të cilat veprojnë si palë të tjera në mënyrë që të kryhet kleringu nga një palë kryesore tjetër. Megjithatë, kur palët e instrumentit mbrojtës zëvendësojnë palët e tjera fillestare të tyre me palë të tjera të ndryshme ky paragraf do të zbatohet vetëm në qoftë se secila prej këtyre palëve bëjnë kleringun me të njëjtën palë kryesore tjetër.
 - (ii) ndryshime të tjera, nëse ka ndonjë, në instrumentin mbrojtës kufizohen në ato që janë të nevojshme për bërë një zëvendësim të tillë të palës tjetër. Ndryshimet e tilla janë të kufizuara në ato që janë në përputhje me kushtet që priten nëse instrumenti mbrojtës është likuiduar fillimisht me palën tjetër të kleringut. Këto ndryshime përfshijnë ndryshimet në kërkesat e kolateralit, të drejtat për të kompensuar tepricat e shumave të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe taksat e ngarkuara.
 - (b) ...
- ...



Mbrojtjet e fluksit monetar

...

101 Në secilën nga rrethanat e mëposhtme, një njësi ekonomike do të ndërpresë në mënyrë prospektive kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafet 95–100:

(a) Instrumenti mbrojtës ka skaduar ose është shitur, nuk merren më përfitime ose është ushtruar ~~(për këtë qëllim, zëvendësimi apo përtëritja e një instrumenti mbrojtës në një instrument tjetër mbrojtës nuk konsiderohet skadim apo ndërprerje e afatit nëse ky zëvendësim ose kjo përtëritje është pjesë e strategjisë të mbrojtjes, e dokumentuar, e njësisë ekonomike)~~. Në këtë rast, fitimi ose humbja neto kumulative nga instrumenti mbrojtës, që është njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse që nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 95 (a)), do të mbeten veçmas në kapitalin neto deri sa të ndodhë transaksioni parashikues. Kur transaksioni ndodh zbatohen paragrafet 97, 98 ose 100. Për qëllim të këtij nënparagrafi, zëvendësimi ose përtëritja e një instrumenti mbrojtës me një instrument tjetër mbrojtës nuk konsiderohet skadim apo mbarim afati në qoftë se ky zëvendësim ose kjo përtëritje është pjesë e strategjisë mbrojtëse të dokumentuar e njësisë ekonomike. Përveç kësaj, për qëllime të këtij nënparagrafi nuk ka skadim apo ndërprerje të afatit të instrumentit mbrojtës, nëse:

- (i) si pasojë e ligjeve apo rregulloreve apo futjes së ligjeve ose rregulloreve, palët e instrumentit mbrojtës janë dakord që një ose më shumë prej palëve të tjera të kleringut të zëvendësojnë palën tjetër fillestare të tyre për t'u bërë palë tjetër e re në secilën prej palëve. Për këtë qëllim, një palë tjetër kleringu është pala tjetër kryesore (e quajtur nganjëherë një "organizatë kleringu 'ose' agjenci kleringu") ose një njësi ekonomike apo disa njësi ekonomike, për shembull, një anëtar i një organizate kleringu ose një klient i një anëtarit kleringu të një organizate kleringu, të cilat veprojnë si palë të tjera në mënyrë që të kryhet kleringu nga një palë kryesore tjetër. Megjithatë, kur palët e instrumentit mbrojtës zëvendësojnë palët e tjera fillestare të tyre me palë të tjera të ndryshme ky paragraf do të zbatohet vetëm në qoftë se secila prej këtyre palëve bëjnë kleringun me të njëjtën palë kryesore tjetër.
- (ii) ndryshime të tjera, nëse ka ndonjë, në instrumentin mbrojtës kufizohen në ato që janë të nevojshme për bërë një zëvendësim të tillë të palës tjetër. Ndryshimet e tilla janë të kufizuara në ato që janë në përputhje me kushtet që priten nëse instrumenti mbrojtës është likuiduar fillimisht me palën tjetër të kleringut. Këto ndryshime përfshijnë ndryshimet në kërkesat e kolateralit, të drejtat për të kompensuar tepricat e shumave të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe taksat e ngarkuara.

(b) ...

Paragrafi 108D është shtuar, ndërsa në shtojcën A është shtuar paragrafi UZ113A.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

...

108D *Zëvendësimi i derivativëve dhe vazhdimi i kontabilitetit mbrojtës* (Ndryshimet në SNK 39), publikuar në qershor 2013, ka ndryshuar paragrafët 91 dhe 101 dhe ka shtuar paragrafin UZ113A. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këta paragrafë për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2014 e në vijim. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2014, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

...

Vlerësimi i efektivitetit të mbrojtjes

...

AG113A Për të shmangur çfarëdo dyshimi, efektet e zëvendësimit të palës tjetër fillestare me një palë tjetër kleringu dhe duke bërë ndryshimet shoqëruese, siç përshkruhet në paragrafët 91 (a) (ii) dhe 101 (a) (ii), do të pasqyrohen në matjen e instrumentit mbrojtës dhe për këtë arsye në vlerësimin e efektivitetit të mbrojtjes dhe matjen e efektivitetit të mbrojtjes.

NJËSITË EKONOMIKE INVESTUESE
(NDRYSHIME TË SNRF 10, SNRF 12 DHE SNK 27)

Ndryshime të SNRF 10 Pasqyra financiare të konsoliduara

Paragrafët 2 dhe 4 janë ndryshuar. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

- 2 Për të arritur objektivin në paragrafin 1 ky SNRF:
- (a) ...
 - (c) përcakton se si aplikohet parimi i kontrollit për të identifikuar nëse një investitor kontrollon një njësi të investuar dhe kështu që ai duhet të konsolidojë njësinë e investuar; ~~dhe~~
 - (d) përcakton kërkesat e kontabilitetit për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe
 - (e) përkufizon një njësi ekonomike investuese dhe përcakton një përjashtim për konsolidimin e filialeve të veçanta të një njësie ekonomike investuese
- 3 ...
- 4 Një njësi ekonomike që është mëmë duhet të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara. Ky SNRF aplikohet tek të gjitha njësitë ekonomike me përjashtim sa më poshtë:
- (a) ...
 - (c) një njësi ekonomike investuese nuk i nevojitet të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara në qoftë se asaj i kërkohet në përputhje me paragrafin 31 të këtij SNRF. T'i vlerësojë të gjitha filialet e saj me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Pas paragrafit 26, titujt dhe paragrafët 27-33 janë shtuar.

Përcaktimi nëse një njësi ekonomike është njësi ekonomike investuese apo jo

- 27 Një njësi ekonomike mëmë duhet të përcaktojë nëse ajo është një njësi ekonomike investuese apo jo. Një njësi ekonomike investuese është një njësi ekonomike që:
- (a) merr fonde nga një ose më shumë investitorë me qëllim që t'u japë këtyre investitorëve shërbime të menaxhimit të investimeve;
 - (b) angazhohet përpara këtyre investitorëve që qëllimi i biznesit të tij është që të investojë me qëllim përfitimi vetëm nga rritja e vlerës së kapitalit, ose vetëm nga të ardhurat nga investimi, apo nga të dyja bashkë; dhe
 - (c) mat dhe vlerëson performancën e pothuaj të gjithë investimeve të tij në bazë të vlerës së drejtë
- Paragrafët B85A-B85M japin udhëzimet përkatëse të zbatimit.**
- 28 Në procesin e vlerësimit nëse ajo plotëson apo jo përkufizimin e përshkruar në paragrafin 27, një njësi ekonomike do të konsiderojë nëse ajo ka karakteristikat tipike të një njësie ekonomike investuese si më poshtë:
- (a) ajo ka më shumë sesa një investim (shiko paragrafët B85O-B85P);
 - (b) ajo ka më shumë sesa një investitor (shiko paragrafët B85Q-B85S);
 - (c) ajo ka investitorë që nuk janë palë të lidhura me njësinë ekonomike (shiko paragrafët B85T-B85U); dhe
 - (d) ajo ka interesa pronësie në formën e kapitalit ose interesa të ngjashme (shiko paragrafët B85V-B85W).

Mungesa e njërit prej këtyre karakteristikave tipike jo domosdoshmërisht e skualifikon një njësi ekonomike për të qenë një njësi ekonomike investuese. Një njësi ekonomike investuese e cila nuk ka asnjë nga këto karakteristika tipike duhet të japë informacione shpjeguese shtesë siç kërkohet nga paragrafi 9A i SNRF 12 *Dhënia e informacionit shpjegues mbi interesat në njësitë e tjera ekonomike.*



- 29 Në qoftë se faktet dhe rrethanat tregojnë që ka ndryshime në një apo më shumë prej këtyre elementëve që përbëjnë përkufizimin e një njësie ekonomike investuese, siç përshkruhet në paragrafin 27, ose sipas karakteristikave tipike të një njësie ekonomike investuese të përshkruara në paragrafin 28, një njësi ekonomike mëmë duhet të rivlerësojë nëse ajo është një njësi ekonomike investuese apo jo.
- 30 Një njësi ekonomike mëmë e cila pushon së qëni si njësi ekonomike investuese ose bëhet rishtas një njësi ekonomike investuese, duhet të marrë parasysh këtë ndryshim në statusin e saj në mënyrë prospektive që nga data në të cilin ndryshimi ka ndodhur (shiko paragrafët B100-B101).

Njësitë ekonomike investuese: përjashtim nga konsolidimi

- 31 Me përjashtim të asaj që përshkruhet në paragrafin 32, një njësi ekonomike investuese nuk duhet të konsolidojë një filial të saj ose të aplikojë SNRF 3 kur ajo merr kontrollin e një njësie tjetër ekonomike. Përkundrazi, një njësi ekonomike investuese duhet të masë një investim në një filial me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në përputhje me SNRF 9.¹
- 32 Pavarësisht nga kërkesa në paragrafin 31, në qoftë se një njësi ekonomike investuese ka një filial që ofron shërbime të cilët lidhen me aktivitetin investues të njësisë ekonomike investuese (shiko paragrafët B85C - B85E), ajo duhet të konsolidojë këtë filial në përputhje me paragrafët 19-26 të këtij SNRF dhe të aplikojë kërkesat e SNRF 3 për blerjen e çdoë filiali të tillë.
- 33 Një njësi ekonomike mëmë e një njësie ekonomike investuese duhet të konsolidojë të gjitha njësitë ekonomike që kontrollojnë, përfshirë ato të kontrolluara nëpërmjet një filiali njësi ekonomike investuese, përveç rastit kur njësia ekonomike mëmë është vetë një njësi ekonomike investuese.

Në Shtojcën A, një përkufizim është shtuar. Teksti i ri është i nënvizuar.

grup

...

Njësi ekonomike investuese

Një njësi ekonomike që:

- (a) merr fonde nga një ose më shumë investitorë me qëllim që t'u japë këtyre investitorëve shërbime të menaxhimit të investimeve;
- (b) angazhohet përpara këtyre investitorëve që qëllimi i biznesit të tij është që të investojë me qëllim përfitimi vetëm nga rritja e vlerës së kapitalit, ose vetëm nga të ardhurat nga investimi, apo nga të dyja bashkë; dhe
- (c) mat dhe vlerëson performancën e pothuaj të gjithë investimeve të tij në bazë të vlerës së drejtë

Në Shtojcën B, titujt dhe paragrafët B85A dhe B85W janë shtuar.

¹ Paragrafi C7 i SNRF 10 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* thekson "Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon këtë SNRF por akoma nuk aplikon SNRF 9, çdo referencë në këtë SNRF për SNRF 9 duhet të lexohet si një referencë për tek SNK 39 *Instrumentet Financiare - Njohja dhe Vlerësimi*".

Përcaktimi nëse një njësi ekonomike është njësi ekonomike investuese apo jo

B85A Një njësi ekonomike duhet të konsiderojë të gjithë faktet dhe rrethanat nëse është një njësi ekonomike investuese, përfshi dhe qëllimin dhe dezajnin e saj. Një njësi ekonomike që përbush të tre elementët e përkufizimit të një njësie ekonomike investuese të përcaktuara në paragrafin 27, është një njësi ekonomike investuese. Paragrafët B85B-B85M përshkruajnë elementët e përkufizimit në detaje të hollësishme.

Qëllimi i Biznesit

B85B Përkufizimi i një njësie ekonomike investuese kërkon që qëllimi i njësisë ekonomike të jetë investimi për qëllimin e vetëm të rritjes së vlerës së kapitalit, të marrë të ardhura nga investimi (siç janë dividendët, interesi ose e ardhura nga qeraja) ose të dyja. Dokumnetet që japin indikatorë se cili janë objektivat e njësisë ekonomike investuese janë të tillë si dokumenti ku përshkruhen llojet e instrumenteve që ofron njësia ekonomike (memorandumi i ofertave), publikimet e shpërndara nga vetë njësia ekonomike ose nga njësi të tjera në partneritet me të, do të jepnin pikërisht evidencë për qëllimin e biznesit të njësisë ekonomike investuese. Evidencë të mëtejshme mund të përfshijmë, mënyrën se si njësia ekonomike, prezanton veten e saj tek palët e tjera (si psh. investitorë potencialë, apo të investuar potencialë); për shëmbull, një njësi ekonomike mund të prezantojë biznesin e saj sikur ofron investime afat mesme për rritje të vlerës së kapitalit. Në të kundërtën një njësi ekonomike e cila prezantohet si një investitor, objektivi i të cilit është që në mënyrë të përbashkët me investuesit e tjerë të zhvillojë, prodhojë ose tregëtojë produkte, ka një qëllim biznesi që është i papajtueshëm me qëllimin e biznesit të një njësie ekonomike investuese, sepse njësia ekonomike do të përfitojë të ardhura nga aktiviteti i zhvillimit, prodhimit apo tregëtimit ashtu si dhe nga investimet e saj (shiko paragrafin B85I).

B85C Një njësi ekonomike investuese mund të ofrojë shërbime të lidhura me investimet (si psh. shërbime të këshillimit për investime, menaxhim investimesh, mbështetje investimesh dhe shërbime administrative), ose drejtpërdrejt ose nëpërmjet një filiali, për palët e treta apo edhe për investitorët e vet, edhe sikur këto aktivitete të jenë thelbësore për njësinë ekonomike.

B85D Një njësi ekonomike investuese mund të jetë pjesëmarrëse gjithashtu në aktivitetet e mëposhtme të lidhura me investimin si drejt për drejt ashtu dhe nëpërmjet një filiali, në qoftë se këto aktivitete janë ndërmarrë për të maksimizuar rikthimin e investimit (ritje e vlerës së kapitalit ose të ardhura nga investimi) nga të investuarit dhe nuk përfaqësojnë një aktivitet biznesi të veçantë në thelb apo një burim të veçantë të ardhurash për njësinë ekonomike investuese:

- (a) dhënia e shërbimit të drejtimit dhe këshillave strategjike për një të investuar; dhe
- (b) dhënia e mbështetjes financiare për një të investuar, siç janë hua, angazhimi ose garantimi i kapitalit.

B85E Në qoftë se një njësi ekonomike investuese ka një filial që ofron shërbime ose aktivitete të lidhura me investimin, si psh. ato të përshkruara në paragrafët B85C-B85D, për njësinë ekonomike ose për palë të tjera, ajo duhet të konsolidojë këtë filial në përputhje me paragrafin 32.

Strategjia e daljes

B85F Gjithashtu edhe planet e investimit të një njësie ekonomike japin evidence për qëllimin e biznesit. Një tipar që diferencon një njësi ekonomike investuese nga njësitë e tjera ekonomike, është që një njësi ekonomike investuese nuk planifikon të mbajë investimet e saj në një kohë të pacaktuar, ajo i mban ato për një periudhë kohore të kufizuar. Për shkak se investimet kapitale dhe investimet me karakter jo financiar kanë potencialin për tu mbajtur për një kohë të pacaktuar, një njësi ekonomike investuese duhet të ketë një strategji dalje e cila dokumenton se si njësia ekonomike planifikon të realizojë rritjen e vlerës së kapitalit në dallim nga investimet e saj kapitale dhe investimet jo financiare. Një njësi ekonomike investuese duhet gjithashtu të ketë një strategji dalje për çdo instrument borxhi që ka potencial për t'u mbajtur për një kohë të pacaktuar, për shëmbull një investimim i përjetshëm borxhi. Njësia ekonomike nuk është nevoja të dokumentojë strategji dalje specifike për çdo investim individualisht por duhet të identifikojë strategji potenciale të veçanta për lloje apo portofle të ndryshme investimesh, duke përfshirë një afat kohor thelbësor për daljen nga investimi. Mekanizmat e daljes që janë vendosur për ngjarje të parazgjedhura si prishja e kontratës, mos performanca, nuk konsiderohen si strategji dalje, për qëllim të këtij vlerësimi.

B85G Strategjitë e daljes mund të variojnë nga lloji i investimit. Për investime në letra me vlerë të kapitalit neto, shëmbuj të strategjisë së daljes përfshijnë një ofertë publike fillestare, një vendosje private, një shitje tregëtare të biznesit, shpërndarje (tek investitorët) e interesave të pronësisë të të investuarve dhe shitjen e aktiveve (përfshi shitjen e aktiveve të një të investuarit që pasohet nga likuidimi i të investuarit). Për investimet në kapitale neto që janë të tregëtueshme në tregun publik, shëmbuj të strategjisë së daljes përfshijnë shitjen e investimit në një



vendosje private ose në një treg publik. Për investimet në pasuri të paluajtëshme, një shëmbull i një strategjie dalje është shitja e pasurisë së paluajtëshme nëpërmjet agjentëve të specializuar të pronave ose në treg të hapur.

- B85H Një njësi ekonomike investuese mund të ketë një investim në një njësi tjetër investuese që është formuar në lidhje me njësinë ekonomike për arsye ligjore, rregullatore, fiskale, ose të tjera arsye të ngjashme biznesi. Në këtë rast, investitori në njësinë ekonomike investuese nuk ka nevojë për një strategji dalje për këtë investim, me kusht që i investuari njësi ekonomike investuese ka një strategji dalje të përshtashme për investimet e saj.

Fitimet nga investimet

- B85I Një njësi ekonomike nuk mund të quhet se ka investuar vetëm për rritje të vlerës së kapitalit, të ardhura nga investimi ose për të dyja, në qoftë se njësi ekonomike ose një anëtar i grupit që zotëron njësinë ekonomike (që do të thotë grupi është i kontrolluar nga një njësi ekonomike investuese njësi ekonomike mëmë përfundimtare) merr ose ka si objektiv të marrë përfitime të tjera nga investimet e njësisë ekonomike që nuk janë të përfitueshme për palët e tjera që nuk janë të lidhura me të investuarin. Përfitime të tilla janë:
- (a) blerja, përdorimi, shkëmbimi ose shfrytëzimi i procesit, aktivitetit ose i teknologjisë së një të investuari. Kjo mund të përfshijë një njësi ekonomike ose një anëtar tjetër të grupit që ka të drejta ekskluzive ose të drejta prioritare për të blerë aktive, teknologji, produkte ose shërbime të një të investuari; për shëmbull, të kesh një opsion për të blerë një aktiv nga një i investuar në qoftë se zhvillimi i atij aktiviteti del me sukses;
 - (b) marrëveshjet e përbashkëta (siç përcaktohen në SNRF 11) ose marrëveshje të tjera midis njësisë ekonomike ose një anëtar të grupit dhe një të investuari për të zhvilluar, tregëtuar ose lëvrimi i produkteve dhe shërbimeve;
 - (c) garancitë financiare ose aktivitetet e ofruara nga një i investuar për t'i shërbyer si kolateral për transaksione huamarrje të njësisë ekonomike ose një anëtar tjetër të grupit (sido qoftë një njësi ekonomike investuese do ishte sërish në gjendje të përdorte një investim në një të investuar si kolateral për çdo huamarrje);
 - (d) një opsion i mbajtur nga një palë e lidhur me njësinë ekonomike për të blerë, nga ajo njësi ekonomike ose nga një tjetër anëtar i grupit, një interes pronësie në një të investuar të njësisë ekonomike.
 - (e) me përjashtim të asaj që është shpjeguar në paragrafin B85J, transaksionet midis një njësie ekonomike ose një anëtar tjetër të grupit dhe një i investuar të cilat:
 - (i) janë në terma të tilla që nuk u ofrohen njësive ekonomike që nuk janë palë të lidhura me njësinë ekonomike, me një anëtar tjetër të grupit, apo me të investuarin;
 - (ii) nuk janë me vlerën e drejtë; ose
 - (iii) përfaqëson një pjesë thelbësore të aktivitetit biznesor të të investuarit ose të njësisë ekonomike, duke përfshirë dhe aktivitetin biznesor të njësive të tjera ekonomike të grupit.
- B85J Një njësi ekonomike investuese mund të ketë një strategji për të investuar në më shumë se një të investuar në të njëjtën industri, treg ose zone gjeografike në mënyrë që të përfitojë nga sinergjitë që sjellin rritje të vlerës së kapitalit dhe të të ardhurave nga investimi nga këto të investuar. Pavarësisht nga paragrafi B85I (e), një njësi ekonomike nuk do të skualifikohet nga të qëniti si njësi ekonomike investuese thjesht sepse këta të investuar tregëtojnë me njëri tjetrin.

Matja me vlerën e drejtë

- B85K Një element thelbësor i përkufizimit të një njësie ekonomike investuese është që ajo i mat dhe vlerëson performancën e pothuaj të gjithë investimeve të saj me vlerën e drejtë, sepse përdorimi i rezultateve të vlerës së drejtë është informacion më i përshtatshëm sesa psh., konsolidimi i filialeve të saj ose përdorimi i metodës së kapitalit neto për interesat e saj në pjesëmarrjet apo në sipërmarrjet e përbashkëta. Në mënyrë që të demonstronjë që ajo e përmbush këtë element të përkufizimit, një njësi ekonomike investuese:
- (a) paraqet tek investitorët informacion me vlerën e drejtë dhe mat pothuaj të gjitha investimet e saj me vlerë të drejtë në pasqyrat financiare të saj atje ku kriteri i vlerës së drejtë kërkohet apo lejohet në përputhje me SNRF-të, dhe
 - (b) raporton me vlerë të drejtë në mënyrë të brendshme tek personeli drejtues kryesor i njësisë ekonomike (siç përcaktohet në SNK 24), i cili përdor vlerën e drejtë si një atribut primar për të vlerësuar performancën e pothuaj të gjithë investimeve të saj dhe për të marrë vendime për investime.
- B85L Në mënyrë që të plotësohen kërkesat sipas B85K(a), një njësi ekonomike investuese duhet:

- (a) të zgjedhë kontabilitetin e modelit të vlerës së drejtë për çdo aktiv afatgjatë material të investuar sipas SNK 40 *Aktiv Afatgjatë Material i Investuar*;
 - (b) të zgjedhë përjashtimin e aplikimit të metodës së kapitalit neto sipas SNK 28 për investimet e saj në pjesëmarrje apo në sipërmarrje të përbashkëta; dhe
 - (c) të masë aktivet e veta financiare me vlerën e drejtë duke përdorur kërkesat e SNRF 9.
- B85M Një njësi ekonomike investuese mund të ketë disa aktive afatgjate jo-të investuara sic mund të jenë ndërtesa e zyrave qëndrore dhe paisjeve përkatëse, dhe mundet gjithashtu të ketë detyrime financiare. Elementi i matjes me vlerën e drejtë të përkufizimit të një njësie ekonomike investuese në paragrafin 27(c) aplikohet për një investim të kryer nga njësi ekonomike investuese. Në këto rrethana, një njësi ekonomike investuese nuk ka nevojë që aktivet e saj jo-të investuara dhe detyrimet t'i masë me vlerën e drejtë.

Karakteristikat tipike të një njësie ekonomike investuese

- B85N Në përcaktimin nëse plotësohet përkufizimi i një njësie ekonomike investuese, njësi ekonomike duhet të konsiderojë nëse ajo shfaq karakteristikat tipike të një të tilla (shiko paragrafin 28). Mungesa e një apo më shumë prej këtyre karakteristikave tipike, jo domosdoshmërisht bën që njësi ekonomike të skualifikohet si njësi ekonomike investuese, por jep indikatorë që nevojitet një gjykim shtesë për të përcaktuar nëse një njësi ekonomike është njësi ekonomike investuese apo jo.

Më shumë sesa një investim

- B85O Një njësi ekonomike investuese zakonisht zotëron shumë lloj investimesh në mënyrë që të diversifikojë rrezikun dhe të maksimizojë të ardhurat. Një njësi ekonomike mund të ketë një portofol investimesh direkte ose indirekte, për shëmbull duke zotëruar një investim në një tjetër njësi ekonomike investuese e cila në vetvete ka shumë investime.
- B85P Mund të ketë edhe kohëra të tilla, kur njësi ekonomike zotëron vetëm një investim. Sido qoftë, zotërimi i një investimi të vetëm nuk e ndalon domosdoshmërisht një njësi ekonomike të plotësojë kushtet e përkufizimit të një njësie ekonomike investuese. Për shëmbull, një njësi ekonomike investuese mund të zotërojë vetëm një investim të vetëm atëherë kur njësi ekonomike:
- (a) ndodhet në periudhë fillestare dhe ende nuk ka arritur të identifikojë investime të përshtatshme, dhe si pasojë, nuk ka zbatuar ende planin e saj të investimeve për të blerë shumë investime;
 - (b) nuk ka bërë ende investime të tjera për të zëvendësuar investimet që ka shitur.
 - (c) është krijuar si pjesë e një grupi investitorësh për të investuar në një investim të caktuar kur një investitor individual nuk mund ta realizojë (psh. kur kërkesa për investimin minimal është shumë e madhe për një investitor individual); ose
 - (d) është në proces likuidimi.

Më shumë sesa një investitor

- B85Q Zakonisht një njësi ekonomike investuese do të kishte shumë investitorë të cilët grumbullojnë fondet e tyre për të patur akses tek shërbimet e drejtimit të investimeve dhe mundësive të investimit që ata mund të mos kenë patur akses në mënyrë individuale. Të paturit e shumë investitorëve e bën më pak të mundur që njësi ekonomike ose anëtarët e tjerë të grupit që zotërojnë njësinë, do të siguronin përfitime të tjera, përveç se rritja e vlerës së kapitalit dhe të ardhurat nga investimi (shiko paragrafin B85I).
- B85R Në mënyrë alternative, një njësi ekonomike investuese mund të formohet nga ose prej një investitori që përfaqëson ose mbështet interesin e një grupi më të gjërë investitorësh (si psh. fondet e pensionit, fondet qeveritare të investimit ose fondet e besuara familjare).
- B85S Mund të ketë edhe kohëra të tilla, kur njësi ekonomike përkohësisht ka një investitor të vetëm. Për shëmbull, një njësi ekonomike investuese mund të ketë vetëm një investitor atëherë kur njësi ekonomike:
- (a) është në periudhën fillestare të ofertave, e cila nuk ka mbaruar ende dhe njësi ekonomike intensivisht është duke identifikuar investitorë të përshtatshëm.
 - (b) nuk ka identifikuar ende investitorë të përshtatshëm për të zëvendësuar interesat pronësore që janë paguar, ose
 - (c) është në proces likuidimi.



Investitorët e pa lidhur

- B85T Zakonisht, një njësi ekonomike investuese ka disa investitorë që nuk janë palë të lidhura (siç përcaktohet në SNK 24) me njësinë ekonomike ose me ndonjë nga anëtarët e grupit që zotëron njësinë ekonomike. Të paturit e investitorëve të palidhur e bën më pak të mundur që njësia ekonomike ose anëtarët e tjerë të grupit që zotërojnë njësinë, do të siguronin përfitime të tjera, përveç se rritja e vlerës së kapitalit dhe të ardhurat nga investimi (shiko paragrafin B85I).
- B85U Gjithësesi, një njësi ekonomike mund të kualifikohet si njësi ekonomike investuese edhe pse investitorët janë palë të lidhura me njësinë ekonomike. Për shëmbull, një njësi ekonomike investuese mund të krijojë veçmas një fond paralel për një grup të punonjësve të saj (si psh. për personelin drejtues kryesor) ose për një pjesë të investitorëve të lidhur, e cila ndjek në mënyrë identike (si pasqyrë) investimin kryesor të njësise ekonomike investuese. Ky fond "paralel" mund të kualifikohet si një njësi ekonomike investuese edhe pse të gjithë investitorët e tij janë palë të lidhura.

Interesi i pronësisë

- B85V Një njësi ekonomike investuese zakonisht është një njësi ligjore e veçantë, por që nuk është e kërkuar të jetë vetëm e tillë. Interesat e pronësisë në një njësi ekonomike investuese janë tipike në formën e interesave të kapitalit neto ose të ngjashme (si psh. interesa të partneritetit), për të cilat atribohen proporcionalisht pjesë të aktiveve neto të njësise ekonomike investuese. Megjithatë, të paturit e klasave të diferencuara të investitorëve, disa prej të cilëve kanë të drejta vetëm për një investim specifik apo grup investimesh, ose të cilët kanë proporcione të ndryshme të aksioneve në aktivet neto, nuk e parandalojnë një njësi ekonomike për të qënë njësi ekonomike investuese.
- B85W Në vazhdim, një njësi ekonomike që ka interesa pronësie të konsiderueshme në formën e borxhit që, në përputhje me SNRF-të e tjera të aplikueshme, nuk e plotësojnë përkufizimin e kapitalit neto, mundet që të kualifikohen si një njësi ekonomike investuese, me kusht që mbajtësit e borxhit të jenë të ekspozuar në forma të varjueshme të kthimit nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve neto të njësise ekonomike.

Në Shtojcën B, janë shtuar një titull dhe paragrafët B100 dhe B101.

Kontabiliteti për një ndryshim në statusin e njësise ekonomike investuese

- B100 Kur një njësi ekonomike pushon së qënuri njësi ekonomike investuese, ajo duhet të aplikojë SNRF 3 për çdo filial të saj që më parë është matur me vlerën e drejtë nëpërmjet Fitimit ose Humbjes në përputhje me paragrafin 31. Data e ndryshimit të statusit, do të konsiderohet si data e blerjes. Vlera e drejtë e filialit në ditën e blerjes duhet të përfaqësojë shumën e transferuar kur matja e çdo emri të mirë ose humbjeje nga një blerje me okazion që do të rrjedhë nga blerja e konsideruar. Të gjitha filialet duhet të konsolidohen në përputhje me paragrafët 19-24 të kësaj SNRF nga data e ndryshimit të statusit.
- B101 Kur një njësi ekonomike bëhet rishtaz njësi ekonomike investuese, ajo duhet të pushojë së konsoliduari filialet e saj në datën e ndryshimit të statusit, me përjashtim për ndonjë filial i cili do të vazhdojë të konsolidohet në përputhje me paragrafin 32. Njësia ekonomike investuese duhet të aplikojë kërkesat e paragrafëve 25 dhe 26 për ato filiale që pushoi së konsoliduari sikur njësia ekonomike investuese të kishte humbur kontrollin e këtyre filialeve në atë datë.

Në shtojcën C, është shtuar paragrafi i ri C1B.

- C1B *Njësitë ekonomike investuese* (shtesat për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), botuar në Tetor 2012, ka ndryshuar paragrafët 2, 4, C2A, C6A, dhe Shtojcën A dhe ka shtuar paragrafët 27-33, B85A-B85W, B100-B101 dhe C3A-C3F. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto amendamente për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Lejohet aplikimi më i hershëm. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto amendamente, ajo duhet të japë informacion shtesë për këtë fakt dhe të aplikojë të gjitha amendamentet e përfshira në *Njësitë Ekonomike Investuese* në të njëjtën kohë.

Në shtojcën C, paragrafi C2A është amenduar. Teksti i ri është i nënvizuar.

- C2A Pavarësisht nga kërkesat e paragrafit 28 të SNK 8, kur kjo SNRF aplikohet për herë të parë, dhe në qoftë se më vonë, kur amendamentet e *Njësive Ekonomike Investuese*, për këtë SNRF aplikohen për herë të parë, një njësi ekonomike i nevojitet vetëm të prezantojë informacionin sasior që kërkohej nga paragrafi 28(f) i SNK 8 për periudhat vjetore që i paraprijnë datës së aplikimit fillestar të kësaj SNRF-je ("periudha më e afërt që i paraprin"). Një njësi ekonomike mund gjithashtu të prezantojë këtë informacion për periudhën aktuale ose për periudha më të hershme krahasuese, por kjo gjë nuk i kërkohej detyrimisht.

Në shtojcën C, janë shtuar paragrafët e rinj C3A-C3F

- C3A Në datën e aplikimit të parë, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë nëse ajo është një njësi ekonomike investuese mbi bazën e fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në atë datë. Në qoftë se, në datën e aplikimit fillestar një njësi ekonomike konkludon se ajo është një njësi ekonomike investuese, ajo duhet të aplikojë kërkesat e paragrafëve C3B-C3F në vend të paragrafëve C5-C5A.
- C3B Përveç ndonjë filiali që është konsoliduar në përputhje me paragrafin 32 (për të cilin aplikohen ose paragrafët C3 dhe C6 ose paragrafët C4-C4A, cilido qoftë i përshtatshëm), një njësi ekonomike investuese duhet të masë investimet e saj në vlerën e drejtë nëpërmjet Fitimit ose Humbjes sikur kërkesat e kësaj SNRF të kishin qënë gjithmonë në fuqi. Njësia ekonomike investuese duhet që në mënyrë retrospektive të rregullojë si periudhën vjetore më të afërt që paraprin datën e aplikimit fillestar, ashtu dhe kapitalin neto në fillim të periudhës më të afërt që i paraprin për çdo diferencë midis:
- (a) vlerës kontabël të filialit; dhe
 - (b) vlerës së drejtë të investimit që njësia ekonomike investuese ka bërë në filial.
- Shuma e akumuluar e çdonjë rregullimi të mëparshëm i njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse duhet të transferohet tek fitime të pa shpërndara në fillim të periudhës vjetore që i paraprin datës së aplikimit.
- C3C Përpara datës së adoptimit të SNRF 13 *Matja me Vlerën e Drejtë*, një njësi ekonomike investuese duhet të përdorë shumat e vlerës së drejtë që më parë janë raportuar tek investitorët ose tek drejtuesit, në qoftë se këto shumat përfaqësojnë shumat për të cilat investimi mund të ishte këmbyer midis palëve të vullnetshme në një transaksion midis palëve të palidhura, në datën e vlerësimit.
- C3D Në qoftë se matja e një investimi në një filial në përputhje me paragrafët C3B-C3C është praktikisht e pamundur (siç përcaktohet në SNK 8), një njësi ekonomike investuese duhet të aplikojë kërkesat e kësaj SNRF në fillim të periudhës më të hershme për të cilën aplikimi i paragrafëve C3B-C3C është i praktikueshëm, e cila mund të jetë dhe periudha aktuale. Investitori në mënyrë retrospektive duhet të rregullojë periudhën vjetore më të afërt që i paraprin datës së aplikimit fillestar, përveç rastit kur fillimi i periudhës më të hershme për të cilën aplikimi i këtij paragrafi është praktikisht i mundshëm përkon me periudhën aktuale. Në qoftë se është ky rasti, atëherë rregullimi në kapitalin neto duhet të njihet në fillim të periudhës aktuale.
- C3E Në qoftë se një njësi ekonomike investuese, ka shitur ose ka humbur kontrollin e një investimi në një filial përpara datës së aplikimit fillestar të kësaj SNRF, njësia ekonomike investuese nuk i kërkohej të bëjë rregullime të mënyrës së kontabilizimit të mëparshëm për këtë filial.
- C3F Në qoftë se një njësi ekonomike, aplikon amendamentet *Njësive Ekonomike Investuese* për një periudhë të mëvonshme sesa kur ajo ka aplikuar SNRF 10 për herë të parë, referencat për "data e aplikimit fillestar" në paragrafët C3A-C3E duhet të lexohen si "fillimi i periudhës raportuese vjetore për të cilën amendamentet *Njësive Ekonomike Investuese* (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), të botuara në Tetor 2012, janë aplikuar për herë të parë."

Në shtojcën C, është ndryshuar paragrafi C6A. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

- C6A Pavarësisht referencës për periudhën vjetore që menjëherë i paraprin datës së aplikimit fillestar ("periudha më e hershme pararendëse") në paragrafët C3B-C4-C5A, një njësi ekonomike mundet gjithashtu të prezantojë informacion krahasues për çdo periudhë të më hershme të paraqitur, por kjo nuk i kërkohej. Në qoftë se një njësi ekonomike paraqet informacion krahasues të rregulluar për çdo periudhë të më hershme, të gjitha referencat për "periudha më e hershme pararendëse" në paragrafët C3B-C4-C5A duhet të lexohen si "periudha më e hershme krahasuese e rregulluar".



Shtojcë Ndryshime që rrjedhin për standarde të tjera

Kjo shtojcë përcakton ndryshimet për Standardet e tjera që vijnë si pasojë e emetimit nga BSNK i Njësitë Ekonomike Investuese (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27). Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Aplikimi më i hershëm i Njësitë Ekonomike Investuese është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto ndryshime, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në Njësitë Ekonomike Investuese në të njëjtën kohë. Paragrafët e ndryshuar janë treguar me tekst të ri të nënvizuar dhe teksti i fshirë me vijë në mes.

SNRF 1 Zbatimi për herë të parë i SNRF-ve

Pargrafi 39T është shtuar.

39T *Njësitë Ekonomike Investuese* (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në Tetor 2012, ka ndryshuar paragrafët D16, D17 dhe Shtojcën C dhe ka shtuar një titull dhe paragrafët E6-E7. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Aplikimi më i hershëm i Njësitë Ekonomike Investuese është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto ndryshime, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në *Njësitë Ekonomike Investuese* në të njëjtën kohë.

Shtojca C është shtuar. Teksti i ri është i nënvizuar.

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e kësaj SNRF. Një njësi ekonomike, duhet të aplikojë kërkesat e mëposhtme për kombinimet e bizneseve që njësi ekonomike ka njohur përpara datës së kalimit në SNRF. Kjo shtojcë duhet të aplikohet vetëm për kombinimet e bizneseve brenda objektit të SNRF 3 Kombinime biznesi.

Në Shtojcën D, paragrafët D16-D17 janë ndryshuar. Teksti i ri është i nënvizuar.

D16 Në qoftë se një filial bëhet zbatues për herë të parë më vonë se shoqëria mëmë, filiali duhet që në pasqyrat e tij financiare të masë aktivet dhe detyrimet e tij:

(a) ose me vlerën kontabël (neto) që do të përfshihet në pasqyrat financiare të konsoliduara të mëmës, bazuar në datën e kalimit të mëmës në SNRF, në qoftë se nuk janë bërë rregullime për procedurat e konsolidimit dhe për efekt të kombinimit të biznesit në të cilin mëmë e ka blerë filialin (kjo mundësi nuk është e vlefshme për një filial siç përcaktohet në SNRF 10 të cilës i kërkohej që të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. ose

(b) ...

D17 Sido qoftë, nëse një njësi ekonomike bëhet zbatues për herë të parë më vonë se filiali i saj (ose një Pjesëmarrje, apo Sipërmarrje e përbashkët e saj), njësi ekonomike duhet që në pasqyrat financiare të konsoliduara të masë aktivet dhe pasivet e filialit (ose të pjesëmarrjes, apo sipërmarrjes së përbashkët) me të njëjtën vlerë kontabël (neto) ashtu siç jepen në pasqyrat financiare të filialit (apo të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët) pasi të jenë bërë rregullimet për konsolidimin dhe për metodën e kapitalit neto dhe për efektet e kombinimit të biznesit në të cilin njësi ekonomike ka blerë filialin. Pavarësisht kësaj kërkesë, një njësi ekonomike mëmë jo-investuese nuk duhet të aplikojë përjashtimin nga konsolidimi që është përdorur nga çdo filial njësi ekonomike investuese. ...

Në Shtojcën E, pas paragrafit E5, janë shtuar një titull dhe paragrafët E6-E7..

Njësitë ekonomike investuese

- E6 Një zbatues për herë të parë që është njësi ekonomike mëmë do të vlerësojë nëse është një njësi ekonomike investuese, siç përcaktohet në SNRF 10, në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e kalimit në SNRF.
- E7 Një miratues për herë të parë që është njësi ekonomike investuese siç përcaktohet në SNRF 10, mund të aplikojë udhëzimet e parshikuara për periudhën tranzitore në paragrafët C3C-C3D të SNRF 10 dhe paragrafët 18C-18G të SNK 27 në qoftë se pasqyrat e para financiare të saj sipas SNRF janë për periudhën vjetore që përfundon në ose më parë se 31 Dhjetor 2014. Referencat në këto paragrafë për periudhat vjetore që i paraprijnë menjëherë datës së aplikimit fillestar duhet të lexohen si periudhat vjetore më të hershme të prezantuara. Si pasojë, referencat në këto paragrafë duhet të lexohen si data e kalimit në SNRF.

SNRF 3 kombinime biznesi

Paragrafi 7 është ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët 2A dhe 64G. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

- 2A Kërkesat e këtij Standardi nuk aplikohen për blerjen nga një njësi ekonomike investuese, siç përcaktohet në SNRF 10, Pasqyrat financiare të konsoliduara, e një investimi në një filial që i kërkohet të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- 7 Udhëzimet në SNRF 10 ~~Pasqyra Financiare të Konsoliduara~~ duhet të përdoren për të identifikuar blerësin ...
- 64G Njësitë Ekonomike Investuese (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), botuar në Tetor 2012, ka ndryshuar paragrafin 7 dhe ka shtuar një titull dhe paragrafin 2A. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Aplikimi më i hershëm i Njësitë Ekonomike Investuese është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto ndryshime, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në Njësitë Ekonomike Investuese në të njëjtën kohë.

SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese

Paragrafi 3 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 44X. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

- 3 Kjo SNRF do të aplikohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjithë instrumentet financiare, përveç:
- (a) ato interesa në filiale, pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkëta që janë kontabilizuar në përputhje me SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara*, SNK 27 *Pasqyra financiare individuale* ose SNK 28 *Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta*. Megjithatë, në disa raste, SNRF 10, SNK 27 ose SNK 28 kërkojnë ose lejojnë një njësi ekonomike të kontabilizojë një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët të përdorin SNRF 9; në këto raste, njësitë ekonomike duhet të aplikojnë kërkesat e kësaj SNRF dhe, për ato të matura me vlerën e drejtë, të aplikojë kërkesat e SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*. Njësitë ekonomike duhet të aplikojnë këtë SNRF gjithashtu për të gjithë derivativët të lidhura me interesat në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët përveç rastit kur këta derivativë plotësojnë përkufizimin e një instrumenti të kapitalit sipas SNK 32.



- 44X Njësitë Ekonomike Investuese (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në Tetor 2012, ka ndryshuar paragrafin 3. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Aplikimi më i hershëm i Njësive Ekonomike Investuese është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këtë ndryshim, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në Njësitë Ekonomike Investuese në të njëjtën kohë.

SNK 7 Flukset e mjeteve monetare

Paragrafët 42A dhe 42B janë ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët 40A dhe 58. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

- 40A Një njësi ekonomike investuese, siç përcaktohet në SNRF 10 Pasqyra financiare të konsoliduara, nuk i nevojitet të aplikojë paragrafët 40(c) ose 40(d) për një investim në një filial që i kërkohet të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- 42A Flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga ndryshimet në interesat e pronësisë në një filial që nuk rezultojnë në humbje të kontrollit duhet të klasifikohen si flukse të mjeteve monetare nga veprimtaria financiare, përveçse kur filiali është i zotëruar nga një njësi ekonomike investuese sipas përcaktimit në SNRF 10, dhe i kërkohet të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- 42B Ndryshimet në interesat e pronësisë në një filial të cilat nuk çojnë në humbjen e kontrollit, siç mund të jetë blerja apo shitja e mëpasshme nga një njësi ekonomike mëmë e një instrumenti të kapitalit neto të një filiali, kontabilizohen si transaksione të kapitalit neto (shiko SNRF 10 ~~Pasqyra financiare të konsoliduara~~), përveçse rastit kur filiali është i zotëruar nga një njësi ekonomike investuese dhe i kërkohet të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Për pasojë, flukset e mjeteve monetare që rezultojnë nga ky transaksion kalsifikohen në të njëjtën mënyrë si dhe transaksionet e tjera me pronarët siç përshkruhet në paragrafin 17.
- 58 Njësitë Ekonomike Investuese (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në Tetor 2012, ka ndryshuar paragrafët 42A dhe 42B dhe ka shtuar paragrafin 40A. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Aplikimi më i hershëm i Njësive Ekonomike Investuese është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto ndryshime, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në Njësitë Ekonomike Investuese në të njëjtën kohë.

SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat

Paragrafët 58 dhe 68C janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 98C. Teksti i ri është i nënvizuar.

- 58 Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë duhet të njihen si të ardhura ose shpenzime dhe të përfshihen në fitim ose humbje të periudhës, me përjashtim nëse tatimi rrjedh nga:
- (a) ...
- (b) një kombinim biznesi (ndryshe nga blerja nga një njësi ekonomike investuese siç përcaktohet në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, e një filiali të cilit i kërkohet të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) (shiko paragrafët 66 deri 68).
- 68C Ashtu siç thuhet në paragrafin 68A, shuma e tatimit që zbritet (ose zbritja e parashikuar e tatimit në të ardhmen, e matur në përputhje me paragrafin 68B), mund të jetë e ndryshme nga shpenzimi përkatës i shpërbërimit të akumuluar. Paragrafi 58 i Standardit kërkon që tatimi aktual dhe ai i shtyrë duhet të njihen si të ardhura ose si shpenzime dhe të përfshihen në fitim ose humbje të periudhës, me përjashtim nëse tatimi rrjedh nga (a) një transaksion ose ngjarje që është njohur, në të njëjtën periudhë ose në një periudhë tjetër, jashtë fitimit ose humbjes, ose (b) një kombinim biznesi (ndryshe nga blerja prej një njësi ekonomike investuese e një filiali të cilit i kërkohet të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes). Në qoftë se shuma e tatimit të zbritur (ose zbritja e parashikuar e tatimit në të ardhmen) e tejkalon shumën e

shpenzimit përkatës të shpërblimit të akumuluar, kjo jep indikatorë që tatimi i zbritur i përket jo vetëm shpenzimit të shpërblimit, por edhe një zëri të kapitalit neto. Në këtë situatë, ky tejkallim i tatimit aktual ose të shtyrë duhet të njihet direkt në kapitalin neto.

98C Njësitë Ekonomike Investuese (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në Tetor 2012, ka ndryshuar paragrafiët 58 dhe 68. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Aplikimi më i hershëm i Njësive Ekonomike Investuese është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto ndryshime, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në Njësitë Ekonomike Investuese në të njëjtën kohë.

SNK 24 Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura

Paragrafët 4 dhe 9 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 28B. Teksti i ri është i nënvizuar.

4 Për transaksion me palët e lidhura dhe tepricat me njësitë e tjera ekonomike në një grup jepet informacion shpjegues në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike. Transaksionet dhe tepricat brënda grupit të palëve të lidhura eliminohen gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara, me përjashtim të atyre midis një njësie ekonomike investuese dhe filialit të saj të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

9 Termat "kontroll" dhe "njësi ekonomike investuese", "kontroll i përbashkët" dhe "Influencë e konsiderueshme" janë përcaktuar në SNRF 10, SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta* dhe në SNK 28 *Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta* respektivisht dhe janë përdorur në këtë Standard me kuptimin që specifikohet në këto SNRF.

28B Njësitë Ekonomike Investuese (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), botuar në Tetor 2012, ka ndryshuar paragrafiët 4 dhe 9. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Aplikimi më i hershëm i Njësive Ekonomike Investuese është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto ndryshime, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në Njësitë Ekonomike Investuese në të njëjtën kohë.

SNRF 32 Instrumentet financiare: Paraqitja

Paragrafi 4 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 97N. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

4 Kjo SNRF do të aplikohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjithë instrumentet financiare, përveç:

(a) ato interesa në filiale, pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkëta që janë kontabilizuar në përputhje me SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara*, SNK 27 *Pasqyra financiare individuale* ose SNK 28 *Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta*. Megjithatë, në disa raste, SNRF 10, SNK 27 ose SNK 28 kërkojnë ose lejojnë një njësi ekonomike të kontabilizojë një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët duke përdorur SNRF 9; në këto raste, njësitë ekonomike duhet të aplikojnë kërkesat e këtij Standardi. Njësitë ekonomike duhet gjithashtu të aplikojnë këtë Standard për të gjithë derivativet të lidhur me interesat në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët.

97N Njësitë Ekonomike Investuese (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në Tetor 2012, ka ndryshuar paragrafin 4. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Aplikimi më i hershëm i Njësive Ekonomike Investuese është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këtë ndryshim, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në Njësitë Ekonomike Investuese në të njëjtën kohë.



SNK 34 Raportim Financiar i Ndërmjetëm

Paragrafi 16A është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 54. Teksti i ri është i nënvizuar.

- 16A Duke shtuar në lidhje me informacionin shpjegues për ngjarjet e rëndësishme dhe transaksionet në përputhje me paragrafët 15-15C, një njësi ekonomike duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të ndërmjetme, në qoftë se nuk janë dhënë diku tjetër në raportin financiar të ndërmjetëm. Informacioni duhet që normalisht të raportohet mbi baza të vitit financiar deri më sot.
- (a) ...
- (k) për njësitë ekonomike që bëhen ose pushojnë së qeni njësi ekonomike investuese, siç përcaktohet në SNRF 10 Pasqyra financiare të konsoliduara, dhënia e informacionit shpjegues në SNRF 12 Dhënia e informacionit shpjegues mbi interesat në njësitë e tjera ekonomike paragrafi 9B.
- 54 Njësitë Ekonomike Investuese (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në Tetor 2012, ka shtuar paragrafin 16A. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 Janar 2014. Aplikimi më i hershëm i Njësive Ekonomike Investuese është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këtë ndryshim, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në Njësitë Ekonomike Investuese në të njëjtën kohë.

SNK 39 Instrumentet Financiare - Njohja dhe Vlerësimi

Paragrafët 2 dhe 80 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 103R. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

- 2 Kjo SNRF do të aplikohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjithë instrumentet financiare, përveç:
- (a) këto interesa në filiale, pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkëta që janë kontabilizuar në përputhje me SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara*, SNK 27 *Pasqyra financiare individuale* ose SNK 28 *Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta*. Megjithatë, në disa raste, SNRF 10, SNK 27 ose SNK 28 kërkojnë ose lejojnë një njësi ekonomike, të kontabilizojnë njësitë ekonomike duhet të aplikojnë këtë Standard një interes në një filial, pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkët që në përputhje me SNK 27 ose SNK 28 është kontabilizuar sipas në përputhje me disa ose të gjitha kërkesat e këtij Standardi. Njësitë ekonomike duhet të aplikojnë gjithashtu këtë Standard për të gjithë derivativët mbi një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët përveç rastit kur këta derivativë plotësojnë përkufizimin e një instrumenti të kapitalit sipas SNK 32. *Instrumentet financiare: Paraqitja*.
- (b) ...
- (g) çdo kontratë "forward" midis një blerësi dhe një aksionmbajtësi shitës për të blerë ose shitur një të blerë që do të rezultojë në një kombinim biznesi brenda objektivit të SNFR 3 *Kombinime Biznesi* në datë blerje të mëvonshme. Termi "kontratë forward" nuk duhet të tejkalojë një periudhë të arsyeshme që normalisht do ishte e domosdoshme për të marrë çdo aprovim të kërkuar dhe të kompletohet transaksioni.
- 80 ... Ai vazhdon që kontabiliteti mbrojtës mund të aplikohet për transaksione midis njësive ekonomike brenda të njëjtit grup vetëm në pasqyrat financiare individuale të atyre njësive ekonomike dhe jo në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit, me përjashtim të pasqyrave financiare të konsoliduara të një njësie ekonomike investuese, siç përcaktohet në SNRF 10, ku transaksionet midis një njësie ekonomike investuese dhe filialeve të saj të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nuk do të eliminohen në pasqyrat financiare të konsoliduara....
- 103R Njësitë Ekonomike Investuese (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në Tetor 2012, ka ndryshuar paragrafi 2 dhe 80. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Aplikimi më i hershëm i Njësive Ekonomike Investuese është i lejuar. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto ndryshime, ajo duhet të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në Njësitë Ekonomike Investuese në të njëjtën kohë.

Ndryshime të SNRF 12 *Dhënia e informacionit shpjegues mbi interesat në njësitë e tjera ekonomike*

Paragrafi 2 është ndryshuar. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

- 2 Për të arritur objektivin në paragrafin 1 një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për:
- (a) gjykimin më të rëndësishëm dhe supozimet që ka bërë në përcaktimin:
 - (i) e natyrës së interesit të saj në një njësi tjetër ekonomike ose në marrëveshje; ~~dhe në përcaktimin~~
 - (ii) e tipit të marrëveshjes së përbashkët në të cilën ka një interes (paragrafët 7-9);
 - (iii) që ajo plotëson përkufizimin e një njësie ekonomike investuese, në qoftë se është e aplikueshme (paragrafi 9A); dhe
 - (b) ...

Pas paragrafit 9, janë shtuar një titull dhe pragrafët 9A-9B.

Statusi i njësisë ekonomike investuese

- 9A **Kur një njësi ekonomike mëmë përcakton që është një njësi ekonomike investuese në përputhje me paragrafin 27 të SNRF 10, njësia ekonomike investuese duhet të japë informacione shtesë rreth gjykimave të rëndësishme dhe supozimet që ka bërë në përcaktimin që ajo është një njësi ekonomike investuese. Në qoftë se njësia ekonomike investuese nuk ka një ose më shumë karakteristika tipike të një njësie ekonomike investuese (shiko paragrafin 28 të SNRF 10), ajo duhet të japë informacion shpjegues për arsyet për të konkluduar që megjithatë është njësi ekonomike investuese.**
- 9B Kur një njësi ekonomike bëhet, ose pushon së qënuri njësi ekonomike investuese, ajo duhet të japë informacion shpjegues për ndryshimin e statusit si njësi ekonomike investuese dhe arsyet e këtij ndryshimi. Gjithashtu, një njësi ekonomike që bëhet njësi ekonomike investuese duhet të japë informacion shpjegues për efektet e ndryshimit të statusit në pasqyrat financiare për periudhën e paraqitur duke përfshirë:
- (a) totalin e vlerës së drejtë, në ditën e ndryshimit të statusit, të filialeve që humbasin të drejtën e konsolidimit;
 - (b) totalin e përfitimit apo të humbjes, në qoftë se ka, të llogaritur në përputhje me paragrafin B101 të SNRF 10; dhe
 - (c) zërin (zërat) e fitimit ose humbjes në të cilat ky përfitim ose humbje është njohur (në qoftë se nuk është paraqitur veçmas).

Pas paragrafit 19, janë shtuar një titull dhe pragrafët 19A-19G.

Interesat në filialet e pa konsoliduara (njësitë ekonomike investuese)

- 19A Një njësi ekonomike investuese, që në përputhje me SNRF 10, i kërkohet të aplikojë përjashtimin e konsolidimit dhe në vend të tij të llogarisë investimet e saj në një filial me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes duhet të japë informacione shtesë për këtë fakt.



- 19B Për çdo filial të pa konsoliduar, një njësi ekonomike investuese duhet të japë informacione shtesë:
- (a) emrin e filialit;
 - (b) adresën kryesore të biznesit (dhe vëndin ku është themeluar, në qoftë se është i ndryshëm nga adresa kryesore e biznesit) të filialit; dhe
 - (c) përqindjen e zotërimit të interesit nga njësia ekonomike investuese dhe, në qoftë se është e ndryshme, përqindjen e të drejtës së votës.
- 19C Në qoftë se një njësi ekonomike investuese është njësi ekonomike apo mëmë e një njësie tjetër investuese, njësia ekonomike mëmë duhet gjithashtu që të japë informacionet shpjeguese në 19B(a)-(c) për investimet që janë të kontrolluara nga filiali i saj si njësi ekonomike investuese. Dhënia e informacioneve shpjeguese mund të bëhet duke përfshirë në pasqyrat financiare të shoqërisë mëmë, pasqyrat financiare të filialit (ose filialeve) që përmbajnë informacionin e mësipërm.
- 19D Një njësi ekonomike investuese duhet të japë informacion shpjegues:
- (a) për natyrën dhe përmasat e kufizimeve të rëndësishme (që rezultojnë nga marrëveshjet huamarrëse, kërkesat rregullatore ose marrëveshjet kontraktuale) mbi aftësinë e një filiali të pa konsoliduar për të transferuar fonde tek njësia ekonomike investuese në formën e dividendëve në mjete monetare ose të ripaguajë hua ose paradhënie të bëra për llogari të filialit të pa konsoliduar nga ana e njësisë ekonomike investuese dhe
 - (b) çdo angazhim aktual ose qëllime për të dhënë mbështetje financiare ose mbështetje në formë të tjera për një filial të pa konsoliduar, duke përfshirë angazhimet ose qëllimet për të ndihmuar filialin në marrjen e mbështetjes financiare.
- 19E Në qoftë se, gjatë periudhës raportuese, një njësi ekonomike investuese ose ndonjë prej filialeve të saj, që nuk kanë detyrime kontraktuale për ta bërë këtë, japin mbështetje financiare ose mbështetje në formë të tjera për një filial të pa konsoliduar (si p.sh. për të blerë një aktiv ose një instrument të emetuar nga filiali ose për të ndihmuar filialin në marrjen e një mbështetje financiare), njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për:
- (a) llojin dhe shumën e mbështetjes së dhënë për çdo filial të pa konsoliduar; dhe
 - (b) arsyet për dhënien e kësaj mbështetje.
- 19F Një njësi ekonomike investuese duhet të japë informacion shpjegues për temat e ndonjë marrëveshje kontraktuale që mund ti kërkojë njësisë ekonomike ose filialit të saj të pa konsoliduar të japë mbështetje financiare për një njësi ekonomike të strukturuar të pa konsoliduar, të kontrolluar, përfshirë dhe rastet apo rrethanat që mund të ekspozojnë njësinë ekonomike raportuese kundrejt një humbje (si p.sh. besueshmërisë në aftësinë likuiduese, përkeqësimit të klasifikimit kreditues të shoqëruar me detyrimin për të blerë aktive të njësisë ekonomike të strukturuar ose të japë mbështetje financiare).
- 19G Në qoftë se gjatë periudhës raportuese një njësi ekonomike investuese ose ndonjë nga filialet e saj të pa konsoliduara, që nuk kanë detyrime kontraktuale për ta bërë këtë, japin mbështetje financiare ose mbështetje në formë të tjera për një njësi ekonomike të strukturuar të pa konsoliduar që njësia ekonomike investuese nuk ka kontroll, dhe nëse dhënia e kësaj mbështetje ka rezultuar në atë që njësia ekonomike investuese të kontrollojë njësinë ekonomike të strukturuar, njësia ekonomike investuese duhet të japë informacion shpjegues dhe sqarime për faktorët përkatës që bënë të arrihej në një vendim të tillë për dhënien e mbështetjes.

Pas paragrafit 21 është shtuar paragrafi 21A

- 21A Një njësi ekonomike investuese nuk i kërkohet të japë informacione shpjeguese sipas paragrafëve 21(b)-21(c).

Pas paragrafit 25 është shtuar paragrafi 25A

- 25A Një njësi ekonomike investuese nuk i kërkohet të japë informacione shpjeguese sipas paragrafëve 24 për një njësi ekonomike të strukturuar që ajo kontrollon dhe për të cilën ajo paraqet informacione shpjeguese që kërkohen nga paragrafët 19A-19G.

Në Shtojcën A, është shtuar një term. Teksti i ri është i nënvizuar.

Termet e mëposhtëm janë përcaktuar në SNK 27 (i rishikuar në 2011), SNK 28 (i rishikuar në 2011), SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta* dhe janë përdorur në këtë SNRF me kuptimet e specifikuar në këto SNRF:

- pjesëmarrje
- pasqyra financiare të konsoliduara
- kontroll i një njësie ekonomike
- metoda e kapitalit neto

- grup
- njësi ekonomike investuese
- marrëveshje e përbashkët
- ...

Në shtojcën C, është shtuar paragrafi C1B.

C1B *Njësitë ekonomike investuese* (ndryshime në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në Tetor 2012, ka ndryshuar paragrafin 2 dhe Shtojcën A dhe ka shtuar paragrafët 9A-9B, 19A-19G, 21A dhe 25A. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Lejohet aplikimi më i hershëm. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto ndryshime, ajo duhet të japë informacion shtesë për këtë fakt dhe të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në *Njësitë Ekonomike Investuese* në të njëjtën kohë.

Ndryshime të SNK 27 Pasqyrat financiare individuale

Paragrafët 5-6 janë ndryshuar. Teksti i ri është i nënvizuar.

- 5 Termat e mëposhtëm janë përcaktuar në Shtojcën A të SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara*, Shtojcën A të SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta* dhe paragrafin 3 të SNK 28 *Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta*:
- pjesëmarrje
 - kontroll i një të investuari
 - grup
 - njësi ekonomike investuese
 - kontroll i përbashkët
 - ...
- 6 Pasqyra financiare individuale janë ato që paraqiten në plotësim të pasqyrave financiare të konsoliduara ose në plotësim të pasqyrave financiare në të cilat investimet në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta janë llogaritur duke përdorur metodën e kapitalit neto, që janë të ndryshme nga rrethanat e përcaktuara në paragrafët 8-8A. Pasqyrat financiare individuale nuk është nevoja t'i bashkangjiten ose të shoqërojnë këto deklarata.

Pas paragrafit 8 është shtuar paragrafi 8A

- 8A Një njësi ekonomike investuese që i kërkohet, për të gjithë periudhën raportuese dhe për të gjitha periudhat krahasuese të paraqitura, të aplikojë përjashtimin nga konsolidimi për të gjitha filialet e saj në përputhje me paragrafin 31 të SNRF 10, paraqet pasqyra financiare individuale si pasqyrat e saj të vetme financiare.

Pas paragrafit 11, janë shtuar paragrafët 11A-11B.

- 11A Në qoftë se një njësi ekonomike mëmë i kërkohet në përputhje me paragrafin 31 të SNRF 10, të masë investimet e saj në një filial me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9, ajo duhet gjithashtu të llogarisë investimet e saj në një filial në të njëjtën mënyrë në pasqyrat e saj financiare individuale.
- 11B Kur një njësi ekonomike mëmë e cila pushon së qëni si njësi ekonomike investuese ose bëhet rishtas një njësi ekonomike investuese, duhet të llogarisë efektet e këtij ndryshimi që nga data në të cilin ndryshimi ka ndodhur si më poshtë:
- (a) kur një njësi ekonomike pushon së qënuri si njësi ekonomike investuese, kjo njësi ekonomike duhet që në përputhje me paragrafin 10:
- (i) ose të kontabilizojë një investim në një filial me kosto. Vlera e drejtë e filialit në datën e këtij ndryshimi në status duhet të përdoret si kosto e paramenduar në këtë datë, ose
- (ii) të vazhdojë të kontabilizojë një investim në një filial në përputhje me SNRF 9.
- (b) kur një njësi ekonomike bëhet rishtas njësi ekonomike investuese duhet të kontabilizojë një investim në një filial me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në përputhje me SNRF 9. Diferenca midis vlerës kontabël (neto) të mëparshme të filialit dhe vlerës së drejtë të tij në datën e ndryshimit të statusit të investitorit duhet të njihet si fitim ose humbje. Shuma e akumuluar e ndonjë rregullimi të vlerës së drejtë që më parë është njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse dhe që i përket këtyre filialeve duhet të trajtohen sikur njësi ekonomike investuese t'i kishte shitur këto filiale në datën e ndryshimit të statusit.



Pas paragrafit 16 është shtuar paragrafi 16A

- 16A** Kur një njësi ekonomike investuese që është njësi ekonomike mëmë (e ndryshme nga një njësi ekonomike mëmë që mbulohet nga paragrafi 16) paraqet, në përputhje me paragrafin 8A, pasqyra financiare individuale si të vetmet pasqyra financiare të saj, ajo duhet të japë informacion shtesë rreth këtij fakti. Njësia ekonomike investuese duhet gjithashtu të japë informacione shpjeguese në lidhje me njësinë ekonomike investuese që kërkohen nga SNRF 12 *Dhënia e informacionit shpjegues mbi interesat në njësitë e tjera ekonomike*.

Paragrafi 17 është amenduar. Teksti i ri është i nënvizuar.

- 17** Kur një njësi ekonomike mëmë (e ndryshme nga një njësi ekonomike mëmë që mbulohet nga paragrafi 16-16A) ose një investitor me kontroll të përbashkët, ose influencë të konsiderueshme mbi një të investuar që paraqet pasqyra financiare individuale, mëma ose investitori duhet të identifikojnë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me cilën prej SNRF 10, SNRF 11, ose SNK 28 (të amenduara në 2011). Mëma ose investitori duhet gjithashtu të japë informacione shpjeguese në pasqyrat e tij financiare individuale:
- (a) ...

Paragrafi 18 është ndryshuar. Teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

- 18** ... Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon këtë Standard më herët, ajo duhet të japë informacione shpjeguese dhe të aplikojë SNRF 10, SNRF 11, SNRF 12 *Dhënia e informacionit shpjegues mbi interesat në njësitë e tjera ekonomike* dhe SNK 28 (të ndryshuara në 2011) në të njëjtën kohë.

Pas paragrafit 18, janë shtuar paragrafët 18A-18I.

- 18A** *Njësitë ekonomike investuese* (ndryshime të SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në Tetor 2012, ka ndryshuar paragrafët 5,6,17, dhe 18, dhe ka shtuar paragrafët 8A, 11A-11B, 16A dhe 18B-18I. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2014. Lejohet aplikimi më i hershëm. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto ndryshime, ajo duhet të japë informacion shtesë për këtë fakt dhe të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në *Njësitë Ekonomike Investuese* në të njëjtën kohë.
- 18B** Në qoftë se, në datën e aplikimit fillestar të ndryshimeve të *Njësitë Ekonomike Investuese* (e cila për qëllime të kësaj SNRF, është fillimi i periudhës vjetore raportuese për të cilën këto ndryshime janë aplikuar për herë të parë), një njësi ekonomike mëmë arrin në konkluzionin që ajo është një njësi ekonomike investuese, ajo duhet të aplikojë paragrafët 18C-18I për investimet e saj në një filial.
- 18C** Në datën e aplikimit fillestar, një njësi ekonomike investuese që më parë ka matur investimet e saj në një filial me kosto duhet që ta masë këtë investim me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes sikur kërkesat e kësaj SNRF të ishin efektive gjatë gjithë kohës. Njësia ekonomike investuese duhet që në mënyrë retrospektive të rregullojë si periudhën vjetore më të afërt që paraprin datën e aplikimit fillestar, ashtu dhe fitimet e pa shpëmdara në fillim të periudhës më të afërt që i paraprin për çdo diferencë midis:
- (a) vlerës së mëparshme kontabël të investimit; dhe
- (b) vlerës së drejtë të investimit që investitori ka bërë në filial.
- 18D** Në datën e aplikimit fillestar, një njësi ekonomike investuese që më parë ka matur investimet e saja në një filial me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbljedhese duhet të vazhdojë të masë këtë

investim me vlerën e drejtë. Shuma e akumuluar e ndonjë rregullimi të mëparshëm i njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse duhet të transferohet tek fitime të pa shpërndara në fillim të periudhës vjetore që i paraprin datës së aplikimit.

18E Në datën e aplikimit fillestar, një njësi ekonomike investuese nuk duhet të bëjë rregullime të kontabilizimeve të mëparshme për një interes në një filial që më parë kishte zgjedhur ta maste me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9, siç e lejon paragrafi 10.

18F Përpara datës së zbatimit të SNRF 13 *Matja me Vlerën e Drejtë*, një njësi ekonomike investuese duhet të përdorë shumat e vlerës së drejtë që më parë janë raportuar tek investitorët ose tek drejtuesit, në qoftë se këto shuma përfaqësojnë shumat për të cilat investimi mund të ishte këmbyer midis palëve të vullnetshme në një transaksion midis palëve të palidhura, në datën e vlerësimit.

18G Në qoftë se matja e një investimi në një filial në përputhje me paragrafët 18C-18F është praktikisht e pamundur (siç përcaktohet në SNK 8 *Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*), një njësi ekonomike investuese duhet të aplikojë kërkesat e kësaj SNRF në fillim të periudhës më të hershme për të cilën aplikimi i paragrafëve 18C-15F është i praktikueshëm, e cila mund të jetë dhe periudha aktuale. Investitori në mënyrë retrospektive duhet të rregullojë periudhën vjetore më të afërt që i paraprin datës së aplikimit fillestar, përveç rastit kur fillimi i periudhës më të hershme për të cilën aplikimi i këtij paragrafi është praktikisht i mundshëm përkon me periudhën aktuale. Data kur për njësinë ekonomike investuese është e mundur të masë vlerën e drejtë të filialit është më e hershme se fillimi i periudhës më të hershme pararendëse, investitori duhet të rregullojë kapitalin neto në fillim të periudhës më të hershme pararendëse për çdo diferencë midis:

(a) vlerës së mëparshme kontabël të investimit; dhe

(b) vlerës së drejtë të investimit që investitori ka bërë në filial.

Në qoftë se periudha më e hershme për të cilën aplikimi i këtij paragrafi është i mundshëm është periudha aktuale, rregullimi i kapitalit neto duhet të njihet në fillim të periudhës aktuale.

18H Në qoftë se një njësi ekonomike investuese, ka shitur ose ka humbur kontrollin e një investimi në një filial përpara datës së aplikimit fillestar të *Njësisë Ekonomike Investuese*, njësisë ekonomike investuese nuk i kërkohet të bëjë rregullime të mënyrës së kontabilizimit të mëparshëm për këtë investim.

18I Pavarësisht referencës për periudhën vjetore që menjëherë i paraprin datës së aplikimit fillestar ("periudha më e hershme pararendëse") në paragrafët 18C-18G, një njësi ekonomike mundet gjithashtu të paraqesë informacion krahasues për çdo periudhë më të hershme të paraqitur, por kjo nuk i kërkohet. Në qoftë se një njësi ekonomike paraqet informacion krahasues të rregulluar për çdo periudhë më të hershme, të gjitha referencat për "periudhën më të hershme pararendëse" në paragrafët 18C-18G duhet të lexohet si "periudha më e hershme krahasuese e rregulluar". Në qoftë se një njësi ekonomike paraqet informacion krahasues të pa rregulluar për ndonjë periudhë më të hershme, ajo duhet të identifikojë qartazi që informacioni nuk është i rregulluar, të deklarojë që informacioni është përgatitur mbi baza të ndryshme, dhe t'i shpjegojë këto baza.



DHËNIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUESE PËR SHUMËN E RIKUPERUESHME PËR AKTIVET JOFINANCIARE (NDRYSHIMET NMË SNK 36)

Ndryshimet në SNK 36 Zhvlerësimi i aktiveve

Paragrafët 130 dhe 134 dhe titulli mbi paragrafin 138 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 140J. Teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është hequr viza mes përmes.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

130 Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese të mëposhtme për një aktiv individual (duke përfshirë emrin e mirë) ose për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare, për të cilët është njohur ose anuluar një çdo materiale humbje nga zhvlerësimi gjatë periudhës për një aktiv individual, duke përfshirë emrin e mirë, ose për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare:

(a) ...

(e) shumën e rikuperueshme të aktivit (njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) dhe nëse shumata e rikuperueshme e aktivit (njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) është vlera e drejtë e tij minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit ose vlera e tij në përdorim.

(f) nëse shumata e rikuperueshme është vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit, baza e përdorur për të matur vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit (në rastin kur vlera e drejtë është matur duke iu referuar një çmimi të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv identik). Një njësi ekonomike nuk i kërkohet të japë informacione shpjeguese siç kërkohet nga SNRF 13, njësi ekonomike duhet të japë informacionin e mëposhtëm:

(i) nivelin e hierarkisë së vlerës së drejtë (shih SNRF 13), brenda së cilës matja e vlerës së drejtë të aktivit (njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) është kategorizuar në tërësinë e saj (pa marrë parasysh nëse "kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit" janë të vëzhgueshme);

(ii) për matjet e vlerës së drejtë të kategorizuara brenda Nivelit 2 dhe Nivelit 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë, një përshkrim i teknikës (teknikave) së vlerësimit të përdorura për të matur vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit. Nëse ka pasur një ndryshim në teknikën e vlerësimit, njësi ekonomike do të japë informacion për këtë ndryshim dhe arsyen (arsyet) pse e ka bërë atë; dhe

(iii) për matjet e vlerës së drejtë të kategorizuara brenda Nivelit 2 dhe Nivelit 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë, çdo supozim kryesor mbi të cilin është bazuar drejtimi në përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit. Supozimet kryesore janë ato për të cilat shumata e rikuperueshme e aktivit (njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) është më e ndjeshme. Njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese edhe për normën (normat) e skontimit të përdorura në matjen aktuale dhe në matjen e mëparshme, nëse vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit matet duke përdorur një teknikë të vlerës aktuale.

(g) ...

...

Vlerësimet që përdoren për të matur shumata e rikuperueshme të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare që përmbajnë emrin e mirë ose të aktiveve jo-materiale me jetë të dobishme të pafundme

134 Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet e kërkuara nga (a) - (f) për çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare (grup njësis) për të cilat vlera kontabël neto e emrit të mirë ose e aktiveve jo-materiale me jetë të dobishme të pafundme të papërcaktuar e shpërndarë në këtë njësi (grup njësis) është e konsiderueshme në krahasim me vlerën kontabël neto gjithsej të emrit të mirë ose të aktiveve jo-materiale me jetë të dobishme të pafundme:

(a) ...

(c) ~~shumata e rikuperueshme e njësisë (ose grupit të njësisë) dhe bazën mbi të cilën shumata e rikuperueshme e njësisë (grupit të njësisë) është përcaktuar (p.sh. vlera në përdorim ose vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit).~~

(d) ...

...

Dispozitat kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

138 ...

140J Në maj 2013 paragrafët 130 dhe 134 dhe titulli mbi paragrafin 138 janë ndryshuar. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2014 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Një njësi ekonomike nuk duhet të zbatojë këto ndryshime në periudha (duke përfshirë periudhat krahasuese), në të cilat ajo nuk zbaton edhe SNRF 13.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 36 lekë